



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2017 – Numri: 85

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 21 prill 2017

## PËRMBAJTJA

|  | Faqe  |      |
|--|---|------|
| Ligj nr. 33/2017<br>datë 30.3.2017               | Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore.....   | 5067 |
| Ligj nr. 34/2017<br>datë 30.3.2017               | Për lirimin e frekuencave të dixhital - dividendit.....   | 5071 |
| Ligj nr. 39/2017<br>datë 30.3.2017               | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.....  | 5074 |
| Ligj nr. 40/2017<br>datë 30.3.2017               | Për disa ndryshime në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.....   | 5075 |
| Ligj nr. 41/2017<br>datë 30.3.2017               | Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.....   | 5078 |
| Ligj nr. 42/2017<br>datë 6.4.2017                | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.....  | 5079 |
| Ligj nr. 43/2017<br>datë 6.4.2017                | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit” .....  | 5084 |
| Ligj nr. 44/2017<br>datë 6.4.2017                | Për disa shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.....   | 5084 |
| Ligj nr. 45/2017<br>datë 6.4.2017                | Për një ndryshim në ligjin nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë” .....  | 5085 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 45/2017, datë 18.4.2017 | Për krijimin dhe përbërjen e komisionit <i>ad hoc</i> me 12 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ..... | 5085 |

Vendim i Kuvendit  
nr. 46/2017, datë 18.4.2017

Për krijimin dhe përbërjen e komisionit *ad hoc* me 6 anëtarë të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” .....

5086



**LIGJ**  
**Nr. 33/2017**

**PËR PAGESËN DHE**  
**FSHIRJEN/SHUARJEN E DETYRIMEVE**  
**TATIMORE, DETYRIMEVE TË**  
**PAGUESHME NË DOGANË, SI DHE**  
**PROCEDURËN E HEQJES NGA**  
**QARKULLIMI TË MJETEVE TË**  
**TRANSPORTIT PAS FSHIRJES**  
**/SHUARJES SË DETYRIMEVE**  
**TATIMORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti i ligjit**

Ky ligj parashikon pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore të papaguara, të detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore të papaguara.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Detyrime tatimore të papaguara” janë tatimi/kontributi/taksa/tarifa, kamatëvonesa dhe çdo dënim administrativ i lidhur ose jo me një lloj tatimi/takse/tarife/kontributi, sipas ligjit nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose ligjeve të tjera tatimore.

2. “Detyrime të pagueshme në doganë” janë detyrime të papaguara që kanë subjektet ndaj autoritetit doganor, përkatësisht taksa doganore, TVSH-ja, akciza, renta, taksa e ambalazhit, taksa e qarkullimit, taksa e karbonit, gjoba, kamatëvonesa, interesat kompensues.

3. “Subjekt” është individ, personi fizik, personi juridik.

4. “Detyrime tatimore të evidentuara në llogarinë e subjektit” janë dënimet administrative të konstatuara nëpërmjet aktkonstatimit deri në datën 31.12.2016.

5. “Detyrime tatimore të regjistruara në llogarinë e subjektit” janë detyrime, njoftim-vlerësimi për të cilat është lëshuar deri në datën 31.12.2016.

**Neni 3**

**Subjektet që përfitojnë**

Nga përcaktimet e parashikuara në këtë ligj përfitojnë:

a) subjektet e regjistruara në regjistrin aktiv, pasiv ose të çregjistruar për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të këtij ligji;

b) subjektet debitore ndaj administratës doganore për detyrime sipas neneve 9, 10 dhe 11 të këtij ligji;

c) subjektet pronare të mjeteve të transportit, siç përcaktohet në nenin 12 të këtij ligji.

**Neni 4**

**Subjektet që nuk përfitojnë**

Nga fshirja/shuarja e detyrimeve të parashikuara sipas këtij ligji nuk përfitojnë subjektet që kanë detyrime tatimore/doganore, të cilat janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës.

**Neni 5**

**Fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore**

1. Fshihen/shuhet detyrimet tatimore të papaguara, sipas përcaktimit në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë dhe që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Fshihen/shuhet detyrimet e papaguara, të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë.

3. Fshihen/shuhet dënimet administrative (gjobat) dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore e shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit.



## Neni 6

**Fshirja/shuarja pjesore e detyrimeve tatimore me kusht pagimin e tatimit /taksës /tarifës /kontributit**

1. Fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të regjistruara në llogarinë e subjektit, me kushtin që, brenda datës 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi për:

a) detyrimet tatimore, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014, duke u aplikuar sipas llojit të tatimit;

b) kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014;

c) taksat/tarifat vendore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 - dhjetor 2014.

2. Ky nen zbatohet edhe në rastin kur tatimi /taksa/tarifa/kontributi është paguar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 7

**Fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore të tjera**

Janë, gjithashtu, objekt i fshirjes/shuarjes, sipas këtij ligji, detyrimet tatimore të mëposhtme, pavarësisht periudhës tatimore së cilës i përkasin:

a) detyrimet tatimore, përfshirë tatimin /kontributin/taksën/tarifën, kamatëvonesën dhe dënimet administrative për subjektet persona fizikë ose juridikë që rezultojnë të çregjistruar në QKB me vendim gjykate apo që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklarim të vonuar, sipas nenit 113, të ligjit nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, deri më 31.12.2016, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve;

c) dënimet administrative (gjobat) për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonesë të pasqyrave financiare të aplikuar, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të llogaritura deri në datën 31.12.2016;

ç) dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat, për deklarata të padorëzuara,

me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.6.2017;

d) dënimet administrative (gjobat) për shoqëritë e autorizuar, të parashikuara në nenin 123, të ligjit nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të evidentuara në llogarinë e subjektit nëpërmjet aktkonstatimit, deri në datën 31.12.2016;

dh) dënimet administrative (gjobat) si rezultat i aplikimit të dispozitave të ligjit nr. 99/2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.8.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese;

e) përveç sa parashikohet në nenin 5, të këtij ligji, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara, sipas përcaktimit në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të detyrimeve të vetdeklaruara dhe të papaguara, të shoqërive që operojnë në sektorin elektroenergjetik dhe janë 100 për qind me kapital shtetëror, që i përkasin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri më 31.12.2013. Gjobat dhe kamatvonesat për kontributet e sigurimeve dhe detyrimet e vetdeklaruara për këto periudha, fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi.

Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri në dhjetor 2014, fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi;

ë) përveç sa parashikohet në nenin 5, të këtij ligji, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara, sipas përcaktimit në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të shoqërive që operojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime dhe janë 100 për qind me kapital shtetëror, që u përkasin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri më 31.12.2013. Gjobat dhe kamatvonesat për kontributet e sigurimeve për këto periudha fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë kontributi.

Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri në dhjetor 2014, fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që



brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi;

f) fshihen/shuhen efektet tatimore për detyrime të papaguara, të regjistruara ose jo apo në proces kontrolli, si pasojë e lëshimit jo brenda së njëjtës periudhë tatimore të kryerjes së furnizimit, të dokumentit që vërteton përjashtimin nga TVSH-ja ose si pasojë e moslëshimit të këtij vërtetimi, me kusht që, në çdo rast, aplikimi pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të jetë paraqitur deri më 31.12.2014;

g) fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të vetëpunësuarit në bujqësi, që i përkasin periudhave nga 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2016, me kusht pagesën e kontributeve brenda datës 31.12.2017.

#### Neni 8

### **Kompensimi i detyrimeve debitore me gjendjen kreditore dhe tepricën kreditore të TVSH-së**

1. Subjektet që kanë tepricë kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11, të këtij ligji, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës deri në masën e tatimit të papaguar.

2. Në rastet kur teprica nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar, atëherë duhet të kryhet pagesa për pjesën e mbetur, sipas nenit 6, të këtij ligji, dhe më pas bëhet fshirja/shuarja e dënimeve administrative.

3. Përcaktimet e këtij neni për kompensimin zbatohen automatikisht, pa kontroll, përveç rasteve të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të këtij ligji, për të cilat ky nen zbatohet kur subjekti heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës kompetente.

4. Sipas këtij neni, kompensimit nuk i nënshtrohen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

#### Neni 9

### **Fshirja/shuarja e detyrimeve të pagueshme në doganë**

1. Fshihen/shuhen nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, të papaguara ndaj administratës

doganore dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate deri në datën 31 dhjetor 2010.

2. Fshihen/shuhen nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, të papaguara ndaj administratës doganore dhe të evidentuara për individët, lidhur me produktet e duhanit, nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate deri në datën 31 dhjetor 2016.

3. Fshihen/shuhen nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, të evidentuara në administratën doganore, për TVSH-në e shtyrë dhe të papaguar për makineritë e pajisjet, importimi i të cilave është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas listës përkatëse në fuqi, deri në datën 31.12.2016.

#### Neni 10

### **Pagesa e detyrimit dhe fshirja/shuarja me kusht e detyrimeve të pagueshme në doganë**

1. Detyrimet e pagueshme në doganë, të evidentuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2014, fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë detyrimi i pagueshëm në doganë, pa përfshirë gjobat, kamatëvonesat dhe interesat kompensues.

2. Detyrimet e pagueshme në doganë, të evidentuara për shkelje të regjimit të lejimit të përkohshëm për automjetet, nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate, nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2016, fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë detyrimi i pagueshëm në doganë, pa përfshirë gjobat dhe kamatëvonesat.

#### Neni 11

### **Detyrimet tatimore dhe doganore që janë në proces ankimi**

1. Subjekti, i cili është në proces ankimi administrativ ose gjyqësor për detyrimet tatimore/detyrimet e pagueshme në doganë, i nënshtrohet këtij ligji nëse ai heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë /ankimit /rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente.

2. Administrata tatimore ose doganore, për detyrimet që fshihen/shuhen, sipas këtij ligji, në rastin kur i ka filluar, ndërpret procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve. Për detyrimet



tatimore ose doganore që nuk përfitojnë nga falja, sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në legjislacionet përkatëse.

Neni 12

**Procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve që nuk janë në përdorim dhe fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore për këto mjete**

1. Përveç sa parashikohet në këtë ligj, në përputhje me përcaktimet, sipas këtij neni, hiqen nga qarkullimi të gjitha mjetet e regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim me këto mjete pas datës 31 dhjetor 2011 e në vijim.

2. Në zbatim të pikës 1, të këtij neni, heqja nga qarkullimi i këtyre mjeteve bëhet pasi fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara për to, si: taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksa vjetore e qarkullimit rrugor, taksa vjetore e mjeteve të përdorura, taksa e mjeteve luksoze, si dhe gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave. Subjektet /personat përgjegjës kanë të drejtë që, brenda datës 31.12.2017, të paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor për të kryer, pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

3. Personave, të cilët paraqiten dhe kërkojnë moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi të mjetit ose mbajtjen aktiv të tij, u fshihen/shuhen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave dhe kamatëvonesave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhen.

4. Nëse brenda datës 31.12.2017 personat e interesuar nuk paraqiten për të kërkuar mbajtjen aktiv të mjetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor do të kryejë, pa pagesë, heqjen nga qarkullimi të mjetit dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore të tij.

5. Lista e mjeteve, me targat përkatëse, të çregjistruara sipas këtij ligji, i dërgohet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së

Policisë së Shtetit për bllokimin dhe sekuestrimin e tyre.

Neni 13

**Afati i zbatimit dhe e drejta e ankimit**

1. E drejta e subjekteve që përfitojnë nga dispozitat e këtij ligji ushtrohet brenda datës 31.12.2017.

2. Subjektet, për të cilat fshirja/shuarja e detyrimit aplikohet me kusht, nuk përfitojnë fshirje/shuarje të detyrimit nëse nuk përmbushin kushtet brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Për çdo subjekt që përfiton ose jo nga fshirja/shuarja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim, duke njoftuar edhe subjektin.

4. Subjektet, të cilat sipas një vendimi të administratave përkatëse nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja, sipas këtij ligji, kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative, sipas legjislacionit të fushës në fuqi.

Neni 14

**Organet zbatuese dhe afati për fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë**

1. Brenda datës 31.12.2017, organet përkatëse fshijnë/shuajnë nga regjistrat e tyre kontabël dhe nga llogaria e subjektit debitor detyrimet që fshihen/shuhen sipas këtij ligji.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji administrata tatimore, qëndrore/vendore, doganore, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Neni 15

**Nxjerrja e akteve nënligjore**

Brenda 15 ditëve nga hyja në fuqi e këtij ligji, Ministri i Financave nxjerr udhëzim për zbatimin e tij.

Neni 16

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10142, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**



**LIGJ**  
**Nr. 34/2017**

**PËR LIRIMIN E FREKUENCAVE TË  
DIXHITAL - DIVIDENTIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi i ligjit**

1. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë vazhdimësinë e marrjes nga publiku të të gjitha programeve TV, transmetuar nëpërmjet rrjeteve tokësore edhe pas kalimit të plotë në transmetimet numerike, nëpërmjet kompensimit të pjesshëm të kostove neto shtesë që shkakton kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike.

2. Ky ligj ka për qëllim të krijojë kushtet për lirin e Dividentit Numerik 1, që përdoret aktualisht për transmetime audiovizive, dhe vënien e frekuencave të tij në përdorim të rrjeteve të komunikimeve të lëvizshme, sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike dhe mediat audiovizive.

3. Ky ligj përcakton masën e kompensimit financiar, mënyrën e krijimit të saj, kategoritë që përfitojnë, mënyrën e kompensimit, procedurën e administrimit dhe të pagesave.

**Neni 2**

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ofruer shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

b) “Operatori i rrjetit numerik” është personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për

shpërndarjen tokësore dhe bashkimin e programeve numerike e të shërbimeve shtesë të përfshira në fluksin numerik të të dhënave.

c) “Operatorë privatë historikë kombëtarë” janë subjektet e licencuara për transmetim televiziv kombëtar, sipas ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të cilët janë ftuar për të marrë pjesë në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike dhe programeve të tyre nëpërmjet *Beauty Contest*.

ç) “Operatorë me eksperiencë në transmetimet numerike” janë subjektet që kanë ofruar shërbim televiziv numerik përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 97/2013, të cilët janë ftuar nga AMA të marrin pjesë në procedurën e licencimit të rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to, sipas procedurës së *Beauty Contest*.

d) “AMA”, Autoriteti i Mediave Audiovizive, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

dh) “AKEP”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

e) “Kosto neto shtesë” është kosto që shoqërojnë kalimin nga transmetimet analoge në transmetime numerike.

ë) “Dividenti Numerik 1” janë frekuencat e brezit 790-862 MHz, që lirohen nga kalimi nga transmetime analoge në transmetime numerike dhe që janë përcaktuar për përdorim nga rrjetet e komunikimeve të lëvizshme.

**Neni 3**

**Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për mbulimin e pjesshëm të kostove neto shtesë që shoqërojnë kalimin nga transmetimet analoge në transmetime numerike dhe që përfshijnë:

a) tarifën e mbështetjes së operatorëve ekzistues analogë lokalë/rajonale në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike të licencuara sipas ligjit për median audiovizive;

b) investime të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike, që dalin jashtë funksionit, si rezultat i ndryshimeve teknologjike të imponuara nga ligji për mediat audiovizive;



c) investime të kryera nga operatorët privatë historikë kombëtarë për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analog në numerik, siç kërkohet nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

#### Subjektet e përfshiuara

Përfshihen nga e drejta e përfitimit të kompensimit financiar, sipas këtij ligji:

a) subjektet që kanë ndërprerë aktivitetin ose iu është hequr licenca e transmetimit nga AMA në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) subjektet që nuk afektohen nga kalimi i transmetimeve analoge në transmetime numerike, si ato që ofrojnë shërbim audioviziv nëpërmjet rrjeteve kabllore CaTv, rrjeteve satelitore, internetit etj.;

c) subjektet që kanë detyrime të papërbushura, sipas legjislacionit për taksat kombëtare edhe ndaj AMA-s, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke përfshirë pagesat vjetore për licencë, si dhe sanksionet gjobë të kthyera në titull ekzekutiv;

ç) subjektet, të cilat përdorin frekuenca pa autorizimin e AMA-s.

## KREU II

### KRIJIMI, PËRDORIMI DHE NDARJA E KOMPENSIMIT FINANCIAR

Neni 5

#### Kompensimi financiar

1. Për vijimin e ofrimit të shërbimit mediatic audioviziv, sipas këtij ligji, dhe krijimin e kushteve për lirimin e Dividentit Numerik 1, jepet kompensim financiar për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

2. Fondet e nevojshme për kompensimin financiar krijohen nga pagesat në vlerën e arritur në procesin e konkurrimit, sipas procedurës së përcaktuar në nenet 68 dhe 69, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për frekuencat e brezit 790-862 MHz, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit nga fituesit e të drejtave të përdorimit të tyre.

3. Masa e kompensimit financiar do të jetë minimalisht 5 000 000 (pesë milionë) euro dhe financohet nga të ardhurat e arkëtuara nga dhënia e

autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të Dividentit Numerik 1. Në çdo rast, kjo masë nuk tejkalon shumën prej 10 për qind të vlerës së arkëtueshme të të ardhurave nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të Dividentit Numerik 1.

4. Ky fond i jepet, në formën e transfertës, Autoritetit të Mediave Audiovizive, për t'u përdorur për kompensimin financiar, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 6

#### Ndarja dhe përdorimi i kompensimit financiar

Masa e kompensimit financiar, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji, do të ndahet dhe do të përdoret si më poshtë:

1. 1/5 e tij do të përdoret për të mbuluar pjesërisht tarifën e mbështetjes së operatorëve ekzistues lokalë/rajonalë në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

2. 2/5 e tij do të përdoren për të mbuluar pjesërisht investimet e operatorëve me eksperiencë në transmetime numerike, që dalin jashtë funksionit, si rezultat i ndryshimeve teknologjike të imponuara nga ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

3. 2/5 e tij do të përdoren për të mbuluar pjesërisht investimet e operatorëve privatë historikë kombëtarë për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit nga analoge në numerike.

4. Mënyra e ndarjes së detajuar brenda secilit nëngrup, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimit të AMA-s, duke respektuar parimin e objektivitetit, të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

Neni 7

#### Mënyra e administrimit të kompensimit financiar

1. Administrimi i fondeve të kompensimit financiar bëhet nga administrata e AMA-s, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. AMA përcakton operatorët ekzistues të rrjeteve analoge lokale/rajonale, që do të mbështeten në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike private, të licencuara sipas





ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të cilët përfitojnë nga kompensimi financiar gjatë vitit të parë.

3. AMA përcakton kompanitë me eksperiencë në transmetimet numerike, që përfitojnë nga kompensimi financiar, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji, dhe ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

4. AMA përcakton operatorët privatë historikë kombëtarë, që përfitojnë nga kompensimi financiar, sipas pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji, dhe ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

5. AMA kryen analizën e ndarjes së kompensimit financiar, sipas nenit 6 të këtij ligji.

6. AMA kryen pagesën përkatëse për përfituesit e kompensimit financiar.

Neni 8

### Llogaritja e kostove neto shtesë

1. Kostoja për tarifën e mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, mbështetet në tarifën e miratuar nga AMA. Ajo llogaritet, për çdo rast, mbi bazën e zonës së mbulimit, sipas licencës, për një vit, nga momenti i lidhjes së kontratës së mbështetjes në rrjetet numerike. AMA, mbi bazën e tarifës së mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së, bën llogaritjen e vlerave të mbështetjes për secilin nga subjektet përfitues.

2. Nëse fondi i shpërndarë sipas pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, rezulton më i ulët se totali në bazë vjetore i tarifave të mbështetjes së të gjitha subjekteve përfituese në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, vlera e mbulimit të tarifës së mbështetjes për çdo subjekt përfitues do të llogaritet me përqindjen që fondi i shpërndarë zë në totalin në bazë vjetore të tarifave të mbështetjes së të gjitha subjekteve përfituese.

3. Subjekti përfitues i kompensimit financiar, sipas pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, duhet, fillimisht, të paguajë në bazë mujore tarifën e mbështetjes në llogarinë e RTSH-së apo të operatorëve të rrjeteve të tjera numerike, të licencuara sipas ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, dhe të

paraqesë faturën bankare përkatëse të pagesës pranë AMA-s.

4. AMA, me marrjen e faturës bankare të pagesës, kalon vlerën e tarifës së mbështetjes në llogarinë e subjektit përfitues.

5. Shpërndarja e kompensimit financiar për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji, bëhet bazuar në raportin e përgjegjësive tatimore të paguara me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 9

### Ekzekutimi i kompensimit financiar

1. AKEP-i, me disponimin për administrim, sipas ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të frekuencave të Dividentit Numerik 1, kryen menjëherë procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit, sipas neneve 68 dhe 69, të këtij ligji. AMA, në bazë të njoftimeve nga AKEP-i mbi të ardhurat e krijuara, kërkon në Ministrinë e Financave transferimin e një pjese të tyre, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji.

2. Me marrjen e kërkesës, sipas pikës 2, të këtij neni, Ministria e Financave transferon në llogari të AMA-s shumën e të ardhurave të kërkuara.

3. AMA, menjëherë pasi konfirmon hyrjen e të ardhurave të kërkuara për kompensimin financiar në llogarinë e vet, verifikon nëse subjektet që përfitojnë nga kompensimi financiar kanë detyrime të papaguara ndaj saj dhe detyrime të papërbushura, sipas legjislacionit për taksat kombëtare.

4. AMA kryen pagesën për subjektet që përfitojnë nga kompensimi financiar, sipas këtij ligji, vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, si dhe pasi të jetë marrë miratimi nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

5. Në momentin e përfundimit të procesit të kompensimit financiar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, çdo e ardhur e mëtejshme që mund të krijohet nga dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të Dividentit Numerik 1 i nënshtrohet përcaktimeve të ligjit



nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 10

### Dispozita kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e aktit nënligjor, sipas pikës 4, të nenit 6, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10143, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

## LIGJ

Nr. 39/2017

### **PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 49/2012, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYKIMIN E MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKES SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:

“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Neni 2

Në nenin 1, pika 1, shkronja ”a” shfuqizohet.

Neni 3

Nenet 4, 5, 6, 6/1, 6/2, 6/3, 6/4 dhe 6/5 shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 7, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përrjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.”.

Neni 5

Neni 58 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 58

### Shkaqet për rekurs

Vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit në rastet që parashikohen në këtë ligj, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë:

a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika e Kolegjit Administrativ ose e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

c) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimin.”.

Neni 6

Pas nenit 60 shtohet neni 60/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 60/1

Gjykata vendos në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 58 i këtij ligji.”.



## Neni 7

Neni 63 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 63

**Vendimet e Gjykatës së Lartë**

Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Administrativ ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;
- c) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit me tjetër trup gjykues;
- ç) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.”.

## Neni 8

Shtojca “Për organizimin e testimit kualifikues për emërimin e gjyqtarëve administrativë të shkallës së parë dhe të apelit” shfuqizohet.

## Neni 9

**Dispozita kalimtare**

Ndihmësit ligjorë, përfshirë ndihmësit ligjorë të gjykatave administrative të shkallës së parë, do të qëndrojnë në detyrë, në përputhje me nenin 165 të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 10

Mosmarrëveshjet mbi marrëdhëniet e punës të punonjësve në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës, që ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë në gjykim në gjykatat administrative, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 11

Çështjet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10144, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**

**Nr. 40/2017**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8678, DATË 14.5.2001, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

## Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

**Baza ligjore e organizimit dhe e funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë**

Ministria e Drejtësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me:

- a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) ligjin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave;
- c) ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;
- ç) ligjin për nëpunësin civil;
- d) ligjet e tjera të posaçme që parashikojnë rregulla lidhur me Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- dh) këtë ligj.”.

## Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:



## “Neni 4

**Statusi i punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë**

1. Funkionarët politikë të Ministrisë së Drejtësisë gëzojnë të drejtat dhe përbushin detyrimet e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

2. Nëpunësit civilë të Ministrisë së Drejtësisë gëzojnë të drejtat dhe përbushin detyrimet e parashikuara në ligjin për nëpunësin civil.

3. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e tjerë rregullohen nëpërmjet dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.

4. Magjistratët mund të komandohen në Ministrinë e Drejtësisë në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Magjistratët e komanduar gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

## Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Bëjnë përjashtim aktet nënligjore dhe shërbimet lidhur me sistemin e drejtësisë, të cilat sipas ligjeve të posaçme janë në kompetencë të organeve të tjera të sistemit të drejtësisë.”

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ministria e Drejtësisë ushtron kompetenca, mbështet, bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e saj, sipas këtij ligji, lidhur me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, me institucionet e sistemit të burgjeve, të shërbimit të provës, të profesioneve të lira, me përjashtim të rasteve kur në ligje të posaçme parashikohet ndryshe.”

## Neni 4

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 6 ndryshohet si më poshtë:

“Objekti i veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “në fushën e drejtësisë” shtohen fjalët “me përjashtim të akteve nënligjore që janë në kompetencë të organeve shtetërore, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme.”

3. Në pikën 6, fjala “Komunitetit” zëvendësohet me fjalën “Bashkimit”.

4. Në pikën 7, pas fjalëve “në përgjithësi” shtohen fjalët “me përjashtim të shërbimeve që janë në kompetencë të organeve shtetërore, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme.”

5. Pikat 8, 9, 11 dhe 17 shfuqizohen.

6. Pika 10 riformulohet si më poshtë:

“10. Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë ankesë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkelje disiplinore të pretenduara të magjistratëve, si dhe mund të kërkojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në gjykata dhe në prokurori.

Ministri i Drejtësisë i përcjell Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kërkesën e motivuar për inspektim, vetëm pasi ka vlerësuar të gjithë informacionin e siguruar, në raport me disponimet ligjore në fuqi, që tregojnë se ka të dhëna të besueshme se magjistrati ka kryer shkelje disiplinore.”

7. Pika 15 riformulohet si më poshtë:

“15. Analizon të dhënat statistikore dhe publikon vjetarin statistikor në fushën e drejtësisë. Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë përcjellin pranë Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të kërkuara, me qëllim botimin e vjetarit statistikor, sipas parashikimeve në ligjet e posaçme. Format i vjetarit statistikor dhe periodiciteti i përcjelljes së informacionit miratohen me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë, pas konsultimit me organet e tjera të sistemit të drejtësisë, sipas fushës që mbulojnë.”

8. Pika 18 riformulohet si më poshtë:

“18. Kujdeset dhe mbështet ushtrimin, organizimin dhe funksionimin e profesionit të avokatit, noterit, arbitrit, ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe të profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të legjisllacionit të posaçëm në fuqi në fushën përkatëse.”

9. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1 me këtë përmbajtje:

“18/1. Mbikëqyr, kontrollon, inspekton dhe bën procedim disiplinor për profesionin e noterit, përbaruesit privat, ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe të profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të legjisllacionit të posaçëm në fushën përkatëse.”



10. Pika 19 shfuqizohet.

11. Pika 20 riformulohet si më poshtë:

“20. Mbështet realizimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme në fushën përkatëse.”.

12. Pika 25 riformulohet si më poshtë:

“25. Ushtron kompetencat lidhur me formimin profesional fillestar dhe vazhdues të subjekteve të parashikuara në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe për përgatitjen profesionale, aftësimin dhe specializimin e subjekteve të ligjeve të posaçme për profesionet e lira në fushën e drejtësisë, në përputhje me parashikimet në ligjet e posaçme.”.

13. Pas pikës 30 shtohen pikat 31 dhe 32 me këtë përmbajtje:

“31. Strukturat përgjegjëse të mbarëvajtjes së teknologjisë i sigurojnë akses Ministrisë së Drejtësisë në nivelin “vizitor”, mbi të dhënat që gjenerohen nga sistemet respektive elektronike të teknologjisë së informacionit dhe dokumentet e prodhuara nga gjykata, që tregojnë ecurinë procedurale të çështjes, me përjashtim të të dhënave dhe dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale të mbrojtura, informacion lidhur me të miturit, sekretet shtetëror, të dhëna financiare dhe tregtare të palëve, çështje të sigurisë së palëve ose të dëshmitarëve, ose çdo të dhënë tjetër dhe informacion të mbrojtur nga ligji.

Strukturat përgjegjëse të mbarëvajtjes së teknologjisë i sigurojnë akses Ministrisë së Drejtësisë në nivelin “vizitor”, mbi të dhënat që gjenerohen nga sistemet respektive elektronike të teknologjisë së informacionit dhe dokumentet e prodhuara nga prokuroria, vetëm pas përfundimit të hetimit, që tregojnë ecurinë procedurale të çështjes, me përjashtim të dokumenteve mbi të dhënat personale të mbrojtura, të informacionit mbi të miturit, të sekretit shtetëror, të të dhënave financiare dhe tregtare të palëve, çështjeve të sigurisë lidhur me palët ose dëshmitarët dhe çdo të dhënë tjetër dhe informacioni të mbrojtur nga ligji.

32. Ministri i Drejtësisë organizon punën për mbledhjen e informacionit, me qëllim përgatitjen

dhe propozimin pranë Këshillit të Ministrave, të rekomandimeve për prokurorinë, në kuadër të luftës kundër kriminalitetit. Ministri i Drejtësisë u bën të njohura rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit, drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve. Ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, Ministri i Drejtësisë kërkon jo më pak se dy herë në vit pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme informacion mbi zbatimin e tyre. Informacioni i marrë vlerësohet nga Ministri i Drejtësisë dhe bazuar mbi gjetjet, i propozon Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë marrjen e masave organizative, sipas ligjit, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve.”.

Neni 5

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Strukturat organizative në Ministrinë e Drejtësisë”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

“Për përmbushjen e kompetencave të veta, Ministri i Drejtësisë miraton rregulla të hollësishme për administrimin e përditshëm të veprimtarisë, funksionimin e brendshëm, përshkrimin e punës të punonjësve, rregullin dhe disiplinën në institucion.”.

Neni 7

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Struktura funksionale dhe organika e hollësishme e institucionit bëhet në përputhje me ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Neni 8

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 18

### Qendra e Botimeve Zyrtare

Qendra e Botimeve Zyrtare është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, përgjegjëse për botimin e Fletores Zyrtare, Buletinit të Njoftimeve Zyrtare dhe për përditësimin dhe mirëfunksionimin e Arkivit Elektronik të Akteve dhe botimeve të tjera, sipas parashikimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare.”.

Neni 9

Pas nenit 18/1 shtohen nenet 18/2, 18/3, 18/4 dhe 18/5 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/2

### Shërbimi i provës

Shërbimi i Provës është shërbim publik, që organizohet dhe funksionon në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me parashikimet në legjislacionin e posaçëm.

Neni 18/3

### Mjekësia ligjore

Instituti i Mjekësisë Ligjore është institucion qendror, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me parashikimet në legjislacionin e posaçëm.

Neni 18/4

### Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor

Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor organizohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18/5

### Agjencia Kombëtare e Falimentimit

Agjencia Kombëtare e Falimentimit, si autoriteti shtetëror kompetent për mbikëqyrjen, trajnimin dhe licencimin e veprimtarisë së administratorëve, organizohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me parashikimet në legjislacionin e posaçëm.”.

Neni 10

### Dispozita kalimtare

Gjyqtarët dhe prokurorët që ushtronin funksione në nivelet drejtuese dhe ekzekutive në

Ministrinë e Drejtësisë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konsiderohen magjistratë të komanduar dhe trajtohen sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10145, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

## LIGJ

Nr. 41/2017

### PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË LIGJIN NR. 152/2013 “PËR NËPUNËSIN CIVIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, shkronja “d” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 4, pika 1, shkronja “b”, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Hiqen fjalët “e Gjykatës së Lartë”.

2. Pas fjalëve “Gjykatës Kushtetuese” shtohen fjalët “e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.



## Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10146, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 42/2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË LIGJIN NR. 9049, DATË 10.4.2003,  
“PËR DEKLARIMIN DHE  
KONTROLLIN E PASURIVE, TË  
DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË  
ZGJEDHURVE DHE TË DISA  
NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

## Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Trajtime preferenciale” përfshin, por nuk kufizohet vetëm në asetet, shërbimet, mallrat ose përfitime të tjera të ngjashme që i jepen ose janë në përdorim nga personi, pa shpërblim, si pasojë e detyrës, marrëveshjeve ose kontratave.”.

## Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronjat “b”, “c”, “ç”, “dh”, “ë”, “f”, dhe “j” ndryshohen si më poshtë:

“b) gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i

Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit;

c) zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, me përjashtim të organeve të vetëqeverisjes vendore;

ç) prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve dhe kryetarët e bashkive;

dh) prokurorët, gjyqtarët, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror dhe drejtuesit e zyrave përmbarimore brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë;

ë) Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i Policisë së Shtetit, drejtorët e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtorët e drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorët e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit, drejtuesi dhe oficerët e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe personeli administrativ i Prokurorisë së Posaçme;

f) Drejtori i Përgjithshëm, zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive në qendër dhe qarqe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

j) administratorët e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe me më shumë se 50 punëtorë.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Mbartin detyrimin për deklarinin edhe subjektet e parashikuara në nenet 26 dhe 27, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”.

## Neni 3

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:



“Neni 3/1

**Deklarimi i pasurisë për kandidatët për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë**

1. Mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe të interesave privatë:

a) kandidatët që shprehin interesin për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë;

b) kandidatët që shprehin interesin për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatët jomagjistatë për pozicionin e inspektorit në Zyren e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon qeverisjen e sistemit të drejtësisë;

c) kandidatët për pranim në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe i diplomuari që kandidon për t'u emëruar magjistrat, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

ç) kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe familjarët e afërm të tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

d) kandidatët për prokuror, oficer hetimi, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe familjarët e afërm të tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

dh) kandidatët, të cilët, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kërkojnë ngritje në detyrë në shkallë më të larta ose të specializuara;

e) kandidatët për anëtar të Gjykatës së Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

ë) kandidatët për kryetarë të gjykatës ose prokurorive të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;

f) çdo person tjetër që ka detyrimin të deklarojë para kandidimit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kandidatët për pozicionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, që janë subjekte që mbartin detyrimin për deklarimin e interesave privatë, sipas parashikimeve të nenit 3, të këtij ligji, i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë. Nëse gjatë 180 ditëve para paraqitjes së kërkesës, kandidati është kontrolluar nga Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer.

3. Inspektorati i Lartë kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, brenda 2 muajve nga paraqitja e deklaratës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Në përfundim të verifikimit, Inspektori i Përgjithshëm u dërgon menjëherë institucioneve përkatëse raportin e verifikimit.”

Neni 4

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë numërohet me numrin 1.

2. Në paragrafin e parë, pas fjalëve “të interesave privatë” shtohen fjalët “brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë”;

3. Në shkronjën “a”, pas fjalëve “të drejtat reale mbi to”, shtohen fjalët “sipas Kodit Civil”.

4. Në shkronjën “b”, pas fjalëve “në regjistrat publikë” shtohen fjalët “dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil”.

5. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Subjektet e përcaktuara në nenin 3/1, të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave interesat privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe detyrimet financiare, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me nenin 5/1, të këtij ligji, dhe sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.”

Neni 5

Në nenin 4/1 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

“Subjektet e këtij ligji, që plotësojnë deklarimin për herë të parë, sipas nenit 5/1, të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në *cash*, jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1,5 (një presje pesë) milionë lekë.”





2. Në paragrafin e dytë, fjala “zyrtarët” zëvendësohet me fjalën “subjektet”.

#### Neni 6

Pas nenit 4/1 shtohet neni 4/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/2

#### **Dorëzimi i deklaratave të interesave privatë**

1. Të gjitha subjektet e ligjit dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarim, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre, personalisht, në formë fizike, të mbyllur në zarf në strukturat përkatëse të institucioneve, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj për të gjitha llojet e deklarimit, ose me mjete të komunikimit elektronik, të vëna në dispozicion nga Inspektorati i Lartë.

2. Nëse dorëzimi bëhet personalisht në strukturat përkatëse të institucioneve, pasqyrohet në një procesverbal, që përfshin të dhënat për identifikimin e deklaratës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi.

3. Deklarata e dërguar me mjete të komunikimit elektronik vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e legjislacionit për nënshkrimin dhe dokumentin elektronik.

4. Subjektet, të cilët nuk janë zyrtarë në momentin e dorëzimit të deklaratës, e dorëzojnë atë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas përcaktimeve të këtij neni, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj.”

#### Neni 7

Në nenin 7, pikat 2, 3 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“2. Deklarimi para fillimit të punës, sipas nenit 5/1, të këtij ligji, dhe ai pas largimit nga funksioni, sipas nenit 7/1, të këtij ligji, janë raste të veçanta të deklarimit periodik.

3. Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarim, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik, të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të

interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

5. Për qëllim të deklarimit para fillimit të detyrës, periodik vjetor apo pas largimit nga funksioni, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrim për deklarim vetëm bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/esja dhe fëmijët madhorë.”

#### Neni 8

Në nenin 11, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet me 3/5 e gjithë anëtarëve të Kuvendit për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.”

#### Neni 9

Në nenin 14, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Në këtë rast Kuvendi vendos me tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.”

#### Neni 10

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime

1. Paragrafi i parë numërohet me numrin 1.

2. Në shkronjën “a”, pas fjalëve “burimeve të pasurive të deklaruara” shtohen fjalët “dhe konfliktit të interesave.”

3. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) drejton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.”

4. Shkronja “b” riformulohet si më poshtë:

“b) njofton, rast pas rasti, Presidentin, Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Kryeministrin, ministrat, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Drejtuesin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe drejtuesit e institucioneve qendrore për parregullsitë e vërtetuara në deklarimin e pasurisë nga punonjësit në juridiksionin e tyre.”

5. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave u përcjell organeve kompetente për hetimin e



shkeljeve disiplinore, një raport të arsyetuar, të shoqëruar me dokumentacionin që lidhet me parregullsitë e vërtetuara për pasurinë e deklaruar.”.

#### Neni 11

Në nenin 16, pika 4, pas fjalëve “të këtij Inspektorati” shtohen fjalët “me propozim të Inspektorit të Përgjithshëm”.

#### Neni 12

Në nenin 17 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “b” shtohen fjalët “dhe me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar”.

2. Pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “c” dhe “d” me këtë përmbajtje:

“c) bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të institucioneve shtetërore për zbatimin e këtij ligji, legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;

d) bashkëpunon me institucionet e tjera, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.”.

#### Neni 13

Në nenin 24, paragrafi i dytë, pas fjalëve “gabime materiale” shtohen fjalët “mospërputhje midis deklaratës së dorëzuar personalisht në formë fizike dhe deklaratës së dorëzuar me mjete të komunikimit elektronik”.

#### Neni 14

Në nenin 25/1 bëhen këto ndryshime;

1. Në pikën 1, shkronjat “a”, “b” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:

“a) çdo 2 vjet për Presidentin e Republikës, deputetët, Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, ministrin, zëvendësministrin, gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Drejtuesin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokatit e Popullit, anëtarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarin e organeve rregullatore ose të

mbrojtjes së konkurrencës, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj;

b) çdo 3 vjet për prefektët, kryetarët e bashkive dhe këshillit të qarkut, nëpunësin civil të nivelit të lartë drejtues të administratës publike, zyrtarët e nivelit të lartë drejtues të administratës doganore dhe tatimore, gjyqtarët e apelit, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, prokurorët e apelit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe oficerët e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit;

d) çdo 5 vjet për zyrtarët e tjerë të papërfshirë në shkronjat e mësipërme;”.

2. Në pikën 4, pas fjalëve “kryhet çdo herë” hiqen fjalët “që gjykohet e nevojshme”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Kontrolli i plotë dhe hetimi administrativ i kryer nga Inspektorati i Lartë përfundon brenda 6 muajve pas fillimit të tij.”.

#### Neni 15

Në nenin 26, në fund të paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Nëse të dhënat e përcaktuara në këtë nen ruhen dhe administrohen në formë elektronike ose nëse përpunimi dhe përditësimi i tyre kryhet në format elektronik ose ndërfaqje elektronike, institucioni publik ose personi juridik publik apo privat ka detyrimin të japë informacionin e kërkuar nëpërmjet sistemit elektronik të Inspektoratit të Lartë, i cili do të mundësojë ndërlidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave të regjistruara në regjistrat apo bazën e të dhënave elektronike të këtyre autoriteteve.

Niveli i aksesimit për secilin rast bëhet nëpërmjet niveleve të sigurisë, me qëllim kryerjen e kontrollit dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës.”.

#### Neni 16

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Të dhënat, që grumbullohen nga deklarimi, sipas këtij ligji, janë të lejueshme për publikun vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Deklaratat e interesave privatë janë dokumente zyrtare dhe publikohen në faqen



zyrtare të internetit të Inspektoratit të Lartë, me të dhënat konfidenciale, personale, të redaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Të dhënat e marra nga institucionet publike dhe/ose private gjatë ushtrimit të kontrollit, rikontrollit të deklaratave të interesave privatë apo hetimit administrativ, përdoren vetëm për qëllime të këtij ligji dhe nuk mund të bëhet publikimi ose shpërndarja e paautorizuar e tyre, në kundërshtim me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi për publikimin dhe përpunimin e të dhënave personale.”.

Neni 17

Në nenin 40, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:

a) Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

b) Për moslëshim autorizimi, sipas nenit 9/1, të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

c) Kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë, sipas nenit 26, të këtij ligji, personat përgjegjës të institucioneve publike dhe private dënohen me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

ç) Kur ekspertët refuzojnë kryerjen e ekspertimit ose kur ata nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, për kryerjen e ekspertimit, sipas nenit 29, të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

d) Për shkelje të detyrimit të parashikuar në nenin 34, pika 3, të këtij ligji, personi përgjegjës dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

dh) Për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm e të konstatuara gjatë veprimtarisë

kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, Inspektori i Përgjithshëm dënon personat përgjegjës me gjobë në masën nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”.

Neni 18

Neni 42/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42/1

1. Subjektet që mbartin detyrimin për deklarim për shkak të funksionit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kryeinspektorit dhe inspektorëve të Inspektoratit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dorëzojnë deklaratat e interesave privatë deri në momentin e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Subjektet që mbartin detyrimin për deklarim për shkak të funksionit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, drejtuesi dhe oficerët e policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe personeli administrativ i Prokurorisë së Posaçme kanë detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, në momentin e krijimit të këtyre institucioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Për efekt të deklarimit të dërguar me mjete të komunikimit elektronik, sipas nenit 4/2 të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme dhe jo më parë se 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Deri në momentin e funksionimit të sistemit elektronik, subjektet e këtij ligji dhe personat e lidhur mbartin detyrimin për të paraqitur deklaratën e interesave privatë, në formë fizike dhe të mbyllur në zarf, në strukturat përkatëse të institucioneve.

4. Për efekt të sigurimit të të dhënave dhe informacionit, sipas nenit 26, të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme dhe jo më parë se 5 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Për efekt të publikimit të deklaratave të interesave privatë, sipas nenit 34, të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme dhe jo më parë se 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.



6. Inspektori i Përgjithshëm, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton formatin e deklaramit për kandidatët për pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë.

7. Inspektori i Përgjithshëm vazhdon të qëndrojë në detyrë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në plotësimin e mandatit 7-vjeçar, të parashikuar në nenin 11, pika 2, të ligjit, pa të drejtë rizgjedhjeje.”.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10147, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 43/2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË LIGJIN NR. 157/2013, “PËR MASAT  
KUNDËR FINANCIMIT  
TË TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 9, pas fjalëve “Prokurori i Përgjithshëm” shtohen fjalët “Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme”.

Neni 2

Në nenin 15, pika 2, pas fjalëve “Prokuroria e Përgjithshme” shtohen fjalët “Prokuroria e Posaçme” dhe pas fjalëve “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” shtohen fjalët “Byroja Kombëtare e Hetimit”.

Neni 3

Në nenin 16, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ministri i Financave mund të urdhërojë, pa njoftim paraprak, bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera, përpara nxjerrjes së vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, kur kjo është e vetmja mënyrë për të parandaluar shmangien nga zbatimi i masave të parashikuara në këtë ligj dhe duhet të njoftojë Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme për efekt të procedimit të mundshëm penal.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10148, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 44/2017**

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 9917,  
DATË 19.5.2008, “PËR PARANDALIMIN  
E PASTRIMIT TË PARAVE DHE  
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 22 bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën “e”, pas fjalëve “Prokurorinë e Përgjithshme” shtohen fjalët “Prokurorinë e Posaçme” dhe pas fjalëve “Policinë e Shtetit” shtohen fjalët “Byronë Kombëtare të Hetimit”.



2. Pas shkronjës “l” shtohet shkronja “m” me këtë përmbajtje:

“m) ushtron çdo detyrë tjetër që i jepet me ligj.”.

Neni 2

Në nenin 22/1, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Informacioni apo të dhënat e dërguara në zbatim të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” trajtohen në përputhje me parashikimet e atij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 23, pika 2, pas fjalëve “Prokurorin e Përgjithshëm” shtohen fjalët “Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme” dhe pas fjalëve “Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKP-së” shtohen fjalët “Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10149, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 45/2017**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.  
163/2014, “PËR URDHRIN E  
PUNONJËSVE SOCIALË NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 13 bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 2, shkronja “ç” shfuqizohet.

Neni 2

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10150, datë 19.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**VENDIM  
Nr. 45/2017**

**PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E  
KOMISIONIT AD HOC ME 12 ANËTARË  
TË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE  
PËR INSTITUCIONET E  
RIVLERËSIMIT, SIPAS LIGJIT NR.  
84/2016, “PËR RIVLERËSIMIN  
KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE  
PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, dhe të nenit 9, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimet e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” me 12 anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare.

II. Përbërja e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve është si më poshtë:



a) Nga grupet parlamentare të shumicës parlamentare caktohen:

1. Pandeli Majko(PS)
2. Bashkim Fino(PS)
3. Ulsi Manja(PS)
4. Evis Kushi(PS)
5. Luan Rama(LSI)
6. Mesila Doda(PDIU)

b) Nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Ilir META

Miraturar në datën 18.4.2017

**VENDIM**  
**Nr. 46/2017**

**PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E  
KOMISIONIT AD HOC ME 6 ANËTARË  
TË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE  
PËR INSTITUCIONET E  
RIVLERËSIMIT, SIPAS LIGJIT NR.  
84/2016, “PËR RIVLERËSIMIN  
KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE  
PROKURORËVE NË REPUBLIKËN  
E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, dhe të nenit 9, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimet e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimin, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me 6 anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare.

II. Përbërja e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve është si më poshtë:

a) Nga grupet parlamentare të shumicës parlamentare caktohen:

1. Vasilika Hysi(PS)
2. Ervin Bushati(PS)
3. Vangjel Tavo(LSI)

b) Nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 18.4.2017

KRYETARI  
Ilir META

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë